



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Prill 2021

Nr: 225

VENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 148, DATË 16.03.2021 “PËR CAKTIMIN E
VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E N

Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 148, datë 16 Mars 2021, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, sipas lidhjes 1 të tij. Bazuar në listën e dërguar të objekteve nga Prefekti i qarkut Shkodër, për VNV e KZAZ-së nr.04, është caktuar palestra e shkollës “Azem Hajdari”.

Prefekti i qarkut Shkodër me shkresën nr.2/25 prot., datë 12.04.2021, i mbështetur në kërkesën e paraqitur nga KZAZ nr.04, si objekt të përshtatshëm për caktimin e VNV-së së ZAZ nr. 04, referon Palestrën e shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali”, duke argumentuar se:

- është ambjent më i përshtatshëm për VNV;
- ka hapësirë më të madhe për të përmbushur masat anti-covid;
- ka ndriçim dhe ajrosje më të mirë të ambjentit;

Ky objekt, sikundër mjedisi përkatës për caktimin e VNV-së, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor. ZAZ nr. 04 ka 46 QV, dhe mjedisi në këtë objekt është me sipërfaqe 635 m2, plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Vendimin e Komisionit Rregullator nr.3, datë 9.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”. Bashkëlidhur shkresës së Prefektit të Qarkut Shkodër, është dhe kërkesa e KZAZ-së nr.04.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit nr. 148, datë 16 Mars 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, bëhet ndyshimi si më poshtë vijon:
 - a) Në Qarkun Shkodër, në KZAZ-në nr.04, objekti i propozuar për VNV, palestra e shkollës “Azem Hajdari” zëvendësohet me palestra e Shkollës “Ismail Qemali”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

